

VENDIM
Nr.15, datë 13.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i“ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i“ “
Kujtim Puto	Anëtar i“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i” “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 27.5.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.28 Akti që i përket:

KËRKUES:FATMIR TUSHA, përfaqësuar nga avokatët Agim Hoxha e Fatmir Gjika, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR:PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.344, datë 9.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f e 134/g të Kushtetutës.

Kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar proces të parregullt për këto shkaqe:

1. Nuk është vënë në dijeni, sipas ligjit, për rekursin e prokurorit ndaj vendimit të gjykatës së apelit që e pushoi çështjen në ngarkim të tij;
2. Nuk ka pasur dijeni për gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë dhe për rrjedhojë nuk është mbrojtur me avokat;
3. Shkelja e këtyre të drejtave ka cenuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim, gjë që e bën procesin të parregullt.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.55, datë 25.6.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka deklaruar fajtor kërkuesin Fatmir Tusha për krimin e vrasjes me dashje në rrethana cilësonjëse, mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal e dënon me 20 vjet burgim; deklarimin fajtor të tij për kundërvajtje penale të mbajtjes pa leje të armës së gjuetisë dhe në bazë të nenit 280 të Kodit Penal e ka dënuar me 3 muaj burgim. Në bashkim të dënimeve, kërkuesi është dënuar me 20 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.314, datë 6.11.2003, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit në dy herë kanosje, sipas nenit 84 të Kodit Penal dhe e pushoi çështjen për shkak se procedimi nuk mund të vazhdojë. Në zbatim të ligjit "Për amnistinë", kjo gjykatë prishi vendimin dhe pushoi çështjen për armëmbajtje pa leje.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që shqyrtoi çështjen mbi rekursin e prokurorit, me vendimin objekt kërkese, vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit përse i përket cilësimit ligjor të veprës, si vrasje me dashje mbetur në tentativë dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal e dënon kërkuesin me 10 vjet burgim.

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, vlerëson se pretendimet e kërkuesit për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas kriterëve të nenit 42 të

Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, janë të bazuara dhe për rrjedhojë kërkesa e tij duhet të pranohet.

Nga materialet e dosjes, të administruara në gjykim, nuk rezulton të ketë ndonjë dokument apo veprim që të vërtetojë se të gjykuarit apo mbrojtësit e tij t'i jetë njoftuar rekursi i prokurorit. Një qëndrim i tillë bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 414 të Kodit të Procedurës Penale, që detyron gjykatën që ka dhënë vendimin t'i komunikojë aktin e ankimit palës tjetër. Shkelja e këtij detyrimi ligjor e ka privuar kërkuesin edhe nga realizimi i së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë, sepse ai nuk është vënë në dijeni se çështja e tij do të shqyrtohej nga kjo gjykatë. Këto shkelje të vazhdueshme të normave kushtetuese e ligjore kanë cenuar të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur, çka e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese duke iu referuar edhe praktikës së saj të mëparshme disa vjeçare ku është mbajtur i njëjti qëndrim për shkelje të kësaj natyre dhe duke e konfirmuar atë, thekson se zbatimi i standardeve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në procesin penal, është një domosdoshmëri dhe kërkesë për të afirmuar shtetin ligjor. Sipas praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, çdo cenim i të drejtave të individit, duhet të jetë objekti i një kontrolli efektiv i kryer nga gjyqësori duke ofruar garancinë më të mirë për pavarësi, paanësi dhe procedurë korrekte.¹

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e 77 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.344, datë 9.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ . Shih çështjen Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë, v.6.9.78